



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2019:241986

Datë: 23.04.2021

Numri i dokumentit: 01727339

P.nr.218/19

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, gjyqtari Sadri Krasniqi, me sekretaren juridike Tevide Thaqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit E.M. nga, për shkak të veprave penale në vazhdim: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 parag. 1 i KPRK-së, lidhur me nenin 77 të KPRK-së, sipas aktakuzave të PTH-së nga Gjilani PP.II.nr.1605/2019, të dt. 08.10.2019, PP.II.Nr.1601/2019 të datës 15.10.2019, PP.II.nr.1927/2020 të datës 12.11.2020 dhe PP.II.Nr.361/2021 të datës 19.03.2021, më datë 13.04.2021, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar në prani të Prokurores së Shtetit Huma Jetishi, të akuzuarit E.M., shpalli dhe komunikoi publikisht, ndërsa më datën 23.04.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I a k u z u a r i :

E.M., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati A. dhe e ëma S., mbiemri i vajzërisë M., i lindur më, në, ku edhe jeton, me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes jo të mirë ekonomike, në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë i akuzuari ka qenë i dënuar më parë për vepër penale.

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse:

I.

- më datë 09.06.2018, në kohë të pa përcaktuar, në shtëpinë e tij në fshatin Lisockë, komuna e Kamenicës, i pandehuri, si konsumatori i energjisë elektrike, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka vjedhur energji elektrike, ashtu që fillimisht të pandehurit pas ndërrimit të njehsorit të vjetër elektrik nga punëtorët e KEDS-it, i njëjti është dërguar në Qendrën e Kalibrimit në Prishtinë ku është konstatuar se njehsori elektrik nga ana e jashtme kapakun nga ana e majtë e ka të shpuar një vrimë, ku përmes vrimës është penguar puna e diskut dhe në brendi të tij është i gërvishur dhe ka një copë të drurit, me çka është pamundësuar regjistrimi i shpenzimeve të energjisë elektrike, në këtë mënyrë të dëmtuarës KEDS-in distrikti në Gjilan, i ka shkaktuar dëm material në shumë të pa përcaktuar.

II.

- më datë 19.09.2018 dhe 27.11.2018, në kohë të pa përcaktuar, në vazhdimësi, në shtëpinë e tij në, i pandehuri E.M., si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, pa autorizim ka shfrytëzuar energji elektrike, ashtu që fillimisht njehsori elektrik i është shkyçur nga distanca për shkak të borxhit ndaj KEDS-it, i pandehuri, pa leje dhe autorizim, ka bërë lidhjen e drejtpërdrejtë në rrjetin elektrik, pa orë matëse, në atë mënyrë që i njëjti ka furnizuar me energji elektrike pajisjet elektrike, përmes të cilave është shpenzuar energjia elektrike në mënyrë të paautorizuar, me çka është pamundësuar regjistrimi i shpenzimeve të energjisë elektrike, në këtë mënyrë të dëmtuarës KEDS-in distrikti në Gjilan, i ka shkaktuar dëm material në shumë të pa përcaktuar.

III.

- më datë 20.06.2019 në kohë të pa përcaktuar,i pandehuri në vazhdimësi në mënyrë të pa autorizuar, ka shfrytëzuar energji elektrike, në atë mënyrë që derisa i pandehuri për shkak të mos pagesës së borxhit është ç`kyçur nga rrjeti elektrik, e me rastin e kontrollimit punëtorët e autorizuar të KEDS-it, kanë konstatuar se i pandehuri E.M., si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim që vetes ti sjellë pasuri të kundërligjshme, ka bërë vjedhjen e energjisë elektrike, ashtu që, ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik, dhe në këtë mënyrë ka bërë harxhimin e pa autorizuar të energjisë elektrike, me çka ka pamundësuar regjistrimin e shpenzuar të energjisë elektrike, duke e dëmtuar, të dëmtuarën KEDS – Distrikti në Gjilan, sipas pro faturave DGLHP208816 e datës 24.01.2020, në shumën prej 65.33 €, DGLHP197834 e datës

21.06.2019 në shumën prej 63.20 €, DGLHP197928 e datës 15.07.2019 në shumën prej 46.36 €, në shumë të përgjithshme prej 109.56 €.

IV.

- më datë 22.05.2020, më datë 19.06.2020 dhe më datë 24.08.2020, në vendbanimin e tij, i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, në vazhdimësi nga rrjeti i të dëmtuarës KEDS-i Distribuimi në Gjilan, ka vjedhë shërbimet për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe duke e shmang pagesën për shërbime të tilla, ashtu që pasi që i është ndal njehsori elektrik nga zyrtarët e KEDS-it me komandë nga distanca për shkak të borxhit paraprak, i pandehuri është lidhur në mënyrë direkte në rrjetin elektrik, jashtë njehsorit elektrik duke e bërë të pamundur të regjistrohet energjia elektrike e shpenzuar dhe në këtë mënyrë KEDS-in Distribuimi në Gjilan e ka dëmtuar në vlerë të pa përcaktuar.

- me çka ka veprat penale: në vazhdim vjedhja e shërbimeve nga neni 314, parag. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit të lartë cekur dhe neneve 4, 38, 39, 43, 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, lidhur me nenin 248, 365 dhe 451 të KPPRK-së, të akuzuarin E.M. e,

G J Y K O N

Me dënim gjobe (në të holla) në shumë prej **150 € (njëqind e pesëdhjetë euro)**, të cilin dënim ka për ta paguar në afatin prej 15 dite nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë të njëjtit do ti zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për çdo 20 €, do ti llogaritet nga një ditë burg.

Pala e dëmtuar i KEDS-it, Distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari Enver Maloku, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzat PP.II.nr.1605/2019, të dt. 08.10.2019, PP.II.Nr.1601/2019 të datës 15.10.2019, PP.II.nr.1927/2020 të datës 12.11.2020 dhe

PP.II.Nr.361/2021 të datës 19.03.2021, ka kërkuar që ndaj të akuzuarit E.M., të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbime nga neni 314 parag. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzat dhe pas vlerësimit të së njëjtave dhe shkresave tjera të lëndëve, konstatoi se e aktakuzat janë të bazuara në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtave, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim gjyqësor kundër të akuzuarit për dat.13.04.2021, në të cilën seancë gjyqësore, përkatësisht në fillim të seancës, gjykata duke pasur parasysh se veprat penale ishin të natyrës së njëjtë për të gjitha këto lëndë, e për shkak të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës, në kuptim të nenit 35, paragrafi 1 dhe 7 të KPPRK-së, me Aktvendimin P.nr.218/2019, bëri bashkimin e lëndëve penale P.nr.218/2019, P.nr.230/2019, P.nr.246/2020 dhe P.nr.40/2021, në mënyrë që në të ardhmen, për të njëjtat çështje penale të zhvillohet një procedurë penale dhe të vendoset me një aktgjykim, ndërsa numri i lëndës për të gjitha këto lëndë do të mbetet ai më i vjetri, përkatësisht P.nr.218/2019. Po ashtu gjykata duke pasur parasysh faktin se për këto lëndë objekti i veprave penale ishte i njëjtë, pala e dëmtuar e njëjtë, dashja e njëjtë e kryesit të veprave penale, e po ashtu duke pasur parasysh edhe afatin kohor të kryerjes së këtyre veprave penale, sipas detyrës zyrtare e në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 360, paragrafi 2 të KPPRK-së, bëri rikualifikimin veprave penale nga vepra penale, vjedhja e shërbimeve nga neni 314, paragrafi 1 të KPRK-së, në veprën penale, *në vazhdim* vjedhja e shërbimeve nga neni 314, paragrafi 1, lidhur me nenin 77 të KPRK-së. Në të cilën seancë pas leximit të aktakuzave nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari E.M., ka deklaruar se i ka kuptuar aktakuzat dhe veprat penale për të cilat akuzohet, njëherit deklaroi se e pranon fajsinë për kryerjen e këtyre veprave penale..

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmbajnë aktakuzat dhe aktakuzat nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari E.M.N, me dashje ka kryer veprat penale, në vazhdim Vjedhje e shërbimeve nga neni 314, parag. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivat e këtij aktgjykimi, për të cilat vepra penale, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarit për veprat penale të kryera, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në shqiptimin e drejtë dhe meritore të dënimit ligjor. Në veçanti për këtë rast si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata pati parasysh faktin se i akuzuari në fillim të shqyrtimit fillestar ka pranuar fajësinë, gjendjen jo të mirë ekonomike të tij, se është pënuar thellë për veprat penale të kryera, por këtë e bënte sepse nuk ka mundësi financiare që ta paguaj borxhin që i ka KEDS-it. Ndërsa gjykata, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese për të akuzuarin.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me gjobë ndaj të akuzuarit E.M., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë të të akuzuarit.

Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

E dëmtuara KEDS – distrikti në Gjilan për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata, bazuar në nenin 451 paragrafi 1 i KPRK-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (Njëzetë euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË KAMENICË,

P.nr.218/2019 më datë. 23.04.2021

Gj y q t a r i,

Sadri Krasniqi,d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimet të aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.